

1.

**Pavlina, tashmë si një sapo e diplomuar e ciklit 5-vjeçar universitar të Fakultetit të Inxhinjerisë dhe Arkitekturës, cila është arsyeja që zgjedhe të studiosh në Universitetin Metropolitan Tirana dhe çfarë gjërash tërhoqën më shumë te ky universitet krahasuar me të tjerët?**

Pas një sfide 5- vjeçare është e vështirë të kthesh kokën pas dhe të reflektosh mbi rrugëtimin e një maturanti të sapo dal nga bankat e gjimnazit. Hezitimi i asokohe ka qenë frika e zgjedhjes së një Universiteti që do të me ofronte sigurimin e karrierës dhe suksesit që unë dëshiroja.

Mes "nje oqeani plot peshkaqenë" unë zgjedha UMT. Zgjedha UMT, për shkak të shume favoreve që ai si universitet ofron. Ekselencia akademike, programet e shumta studimore, mundësitë e shkëmbimit në Universitetet Partnere si dhe bashkëpunimet me kompani brenda dhe jashtë vendit kanë qenë disa prej arsyeve që u benë shkak i zgjedhjes time. Si një studente me bursë 100%, personalisht do e cilësoja UMT si ndihmën ekonomike të çdo studenti.

2.

**Si do ta përshkruaje atmosferën dhe kulturën e universitetit? Cilat janë vlerat që shkolla promovon dhe si kanë ndikuar ato në përvojën tënde universitare?**

Atmosfera dhe kultura në Universitetin Metropolitan Tirana është shumë miqësore dhe inkurajuese. Universiteti promovon bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke midis studentëve dhe stafit akademik. Vlerat e shkollës përqendrohen në inovacion, profesionalizëm dhe angazhim të lartë ndaj kërkesave të tregut të punës. Kjo kulturë ka ndikuar në përvojën time universitare duke më inkurajuar të eksploroj mundësitë e kreativitetit dhe të zhvilloj aftësitë e mija.

3.

**Si po përdor teknologjinë dhe burimet digjitale për të përmirësuar profesionin dhe organizimin e punës tuaj akademike?**

Në ditët e sotme teknologjia luan një rol shumë të madhë në përcaktimin drejt suksesit. Pavarësisht faktit se shumë prej software-ëve kanë qenë lendë mësimore të fakultetit, unë sot jam zotëruese në përdorimin e shume platformave që ndihmojnë në zhvillimin dhe ecurinë time profesionale. Të përshatshme dhe të domosdoshme për çdo student dhe të diplomuar une do lista: programet 2D dhe 3D (AutoCAD, Revit, 3ds Max), programet e renderizimit siç mund të jenë V-ray, Lumion, paketat e Adobe (Photoshop, Illustrator, Indesign), dhe sigurisht platformat e Microsoft Office ku kryeson Power Point, në aftësitë prezantuese.

4.

**Cili është projekt-i i ndërmarrë nga ti që ke pasur më shumë pasion dhe krenari? Si e ke realizuar dhe si ka ndikuar kjo përvojë në rritjen tënde akademike?**

Të shumta janë projektet në të cilat jam angazhuar deri më sot. Fatkeqësisht natyrore si dhe humbja e vlerave në kohë shpeshherë më bejnë të reflektojë mbi rolin e arkitektit. Vazhdojë të mendoj se një arkitekt duhet ti shërbeje popullit për ti ofruar atij një jetesë të sigurt dhe komode. Ai si personazh duhet të dashuroi profesionin e tij dhe të mbroji vlerat artistike dhe kulturore, të cilat i japin gjuhë dhe indetitet qytetit. Prandaj dhe shumica e projekteve i dedikohen rinovimit, rijetësimit dhe restaurimit të objekteve të rrënuara. Së fundi jam angazhuar në restaurimin e mbi 40 banesave të shkatëruar nga uragani 'Ian' në Florida. Gjithashtu një projekt që kam pasur mundësi ti përkushtohem për të rikthyer vlerat e tij kulturore, të humbura bë kohë është: Rijetësimi i trashëgimisë kulturore: Ish Uzina e Autotraktorëve, në Tiranë.



Contact info: [pavlina.kumbulla@hotmail.com](mailto:pavlina.kumbulla@hotmail.com)



## Intervistë AND QA me *pavlinakumbulla*

**Pavlina, krahas profesionit tënd, si preferon të kalosh kohën tënde të lirë?**

Është e vështirë të përshtatësh punën me jetën personale dhe sociale. Kohë më pare, një prej pedagogëve tim të ndreruar më ka dhenë një këshillë: Të organizosh kohën tënde për të ndërthurur çdo gjë nga pak: punën, familjen dhe argëtimin. Kështu dhe unë, si një person me natyrë eksploruese, preferoj të shpenzoj kohën time të lirë nëpër udhetime.

**Si po përgatitesh për një karrierë pas përfundimit të studimeve? A ke planifikuar praktika, stazhe apo mundësi të tjera për të zhvilluar përvojën praktike në fushën tënde të interesit?**

Si rrjedhojë e të gjitha arsyeve që kam listuar, kam mundur të hedh hapat e parë kundrejt karrierës time profesionale. Unë sot ndodhem e punësuar me kohë të plotë në një kompani arkitekturë, "Millworth Group Inc.", e cila është e pozicionuar në Naples, Florida.



**A ke ndonjë këshillë të veçantë për studentët e rinj që po marrin përgjegjësitë e universitetit për herë të parë?**

Studentët duhet të jenë të hapur, të gatshëm të eksplorojnë fushat e ndryshme të studimit dhe të marrin pjesë në aktivitete të shumta universitare. Kjo do t'i ndihmojë të gjejnë fushën e interesit të tyre dhe të krijojnë kontakte me studentë dhe profesorë që mund të jenë burime të vlefshme për zhvillimin e tyre akademik edhe atë profesional.

Mos hezitoni, të merrni guximin të mposhtni frikën e së ardhmes. Çdo pengesë apo dështim është një hap kundrejt suksesit.

5.

6.

7.